



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 janar 2012
Nr. ref.: RK172/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 35/10

Parashtruesi

Skender Zenuni

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren
KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Skender Zenuni, nga Gjilani.

2. Parashtruesi i kërkesës pretendon, pa specifikuar ndonjë dispozitë të caktuar të Kushtetutës, se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë, për shkak të korrupsionit, të pretenduar, të gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Gjiilan.
3. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Vendimi i kontestuar

4. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010, i cili i ishte dorëzuar atij më 3 shkurt 2010.

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 janar 2010, parashtruesi i kërkesës i shkroi letër Gjykatës (në tekstin mëtejshëm: Gjykata) duke pretenduar korrupsionin e gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Gjiilan.
6. Më 28 janar 2010, Sekretariati i Gjykatës i shkroi letër parashtruesit të kërkesës duke i propozuar atij që t'i drejtohet Zyrës së Prokurorit Disiplinor në Prishtinë.
7. Më 11 shkurt 2010, Gjykata pranoi kërkesën nga parashtruesi i kërkesës, i cili pretendon shkeljen e të drejtave të tij individuale njerëzore.
8. Më 30 mars 2010, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë Vendimin e kontestuar KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010, i cili i ishte dorëzuar atij më 3 shkurt 2010, si dhe një kopje të ankesës ndaj atij vendimi që parashtruesi i kërkesës pretendohet ta ketë paraqitur më 5 shkurt 2010.
9. Më 12 prill 2010, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj letrës së Gjykatës të 30 marsit 2010, dhe paraqiti vetëm Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren KP Nr. 3/2010, të datës 29 janar 2010.
10. Më 24 gusht 2010, Gjykata njoftoi Gjykatën Komunale në Prizren lidhur me kërkesën.
11. Më 30 gusht 2010 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesues), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami. Më 28 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe dokumenteve në dosjen e rastit, faktet e rastit mund të përmbliidhen si vijon:
13. Më 18 korrik 2008, parashtruesi i kërkesës ngriti padi private penale kundër gjyqtarit M.A., të Gjykatës Komunale në Prizren për *inter alia*, vepër të supozuar penale kundër nderit dhe reputacionit, paraparë me nenin 190 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK, UNMIK/REG/2003/25) dhe vepër penale për lëshimin e vendimeve gjyqësore të paligjshme, paraparë me nenin 346 të KPPK-së.
14. Më 11 janar 2010, Gjykata Komunale në Prizren nxori Vendimin PKA Nr 163/09 dhe hodhi poshtë padinë private penale të parashtruesit të kërkesës, si dhe ndërpreu

procedurat penale ndaj të paditurit. Gjykata Komunale në Prizren, në arsyetimin e Vendimit PKA Nr 163/09, thekson se padia private penale e parashtruesit të kërkesës është e parregullt dhe e parashkruar.

15. Sipas këshillës juridike, dhënë në vendimin e lartpërmendur të Gjykatës Komunale në Prizren, parashtruesi i kërkesës pati mundësinë të parashtrojë ankesë kundër atij vendimi brenda afatit prej 3 ditësh.
16. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ai ka paraqitur ankesë ndaj Vendimit të Gjykatës komunale në Prizren të lëshuar më 11 janar 2010.
17. Më 29 janar 2010, Gjykata Komunale në Prizren lëshoi Vendimin Nr.3/2010 dhe refuzoi si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Vendimit të 11 janarit 2010. Në atë Vendim ishte cekur se *inter alia*, parashtruesi i kërkesës nuk është sjellë në pajtueshmëri me neni 361(1) të KPPK-së dhe se nuk e ka sqaruar padinë e tij private penale. Më tej u theksua se padia private penale ishte e parashkruar.
18. Sipas kërkesës, duket se parashtruesi i kërkesës e pranoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Prizren Nr.3/2010, më 3 shkurt 2010, dhe se ai u ankua më 5 shkurt 2010. Duket se procedura kundër vendimit të Gjykatës Komunale nuk ka përfunduar ende. Për më tepër, në bazë të dokumenteve në dosjen e rastit duket se, më 2 shkurt 2010, Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) e informoi parashtruesin e kërkesës se ka shqyrtuar parashtruesin e parashtruesit të kërkesës, të datës 10 korrik 2008 dhe të datës 13 mars 2009, përmes së cilës parashtruesi i kërkesës pretendon parregullsi të ndryshme në procedurat e rastit Nr. 51/200 nga ana e gjyqtarit M.A., dhe kërkoi shkarkimin e tij nga rasti i parashtruesit të kërkesës.
19. Në parashtruesin e ZPD-së u theksua se *inter alia*, “ZPD-ja ka siguruar dosje gjyqësore dhe intervistuar dëshmitarë të rëndësishëm, dhe ka gjetur se Gjykata ka proceduar rastin sipas kërkesës së paditësit R.H. kundër M.Z. për vlefshmërinë e pronës... Gjykata Supreme me vendimin e vet Rev Nr. 71/02, të datës 26 qershor 2003, ktheu dy aktgjykimet dhe rasti u rihap për procedim. Rasti mori një numër të ri, C.Nr. 361/03, procedurat e të cilit u ndërpre në më 6 shkurt 2004, me rastin e vdekjes së paditësit. Asnjëra nga palët nuk kërkoi vazhdimin e procedurave të ndërprera më 6 shkurt 2004”. ZPD-ja më tej deklaroi se, “Skender Zenuni (përkatësisht parashtruesi i kërkesës) më 14 maj 2008, ka iniciuar procedurat gjyqësore C.Nr.212/08 për pengim të posedimit... procedurat janë në zhvillim.” Në bazë të kësaj që u tha më lart, ZPD-ja ka deklaruar se për momentin nuk do të merret me hetime disiplinore. Në rast të deklarimit shtesë, parashtruesi i kërkesës këshillohet të kontaktojë me ZPD-në.
20. Historiku i padisë private penale të parashtruesit të kërkesës dhe parashtrësia në ZPD daton qysh nga 1980, kur Gjykata Komunale në Gjilan nxori Aktgjykimin C.Nr. 30/80, lidhur me kontestin mes dy vëllezërve (njëri prej të cilëve është babai i parashtruesit të kërkesës), në lidhje me pronën e paluajtshme që ua kishte lënë babai i tyre i ndjerë. Më 10 qershor 1986, Gjykata Komunale në Gjilan miratoi vendimin për ndarjen e pronës së paluajtshme në fjalë. Në vitin 1988, Gjykata e Qarkut hodhi poshtë ankesën e një personi tjetër, X.H., i cili pretendoi se prona ishte e tij. Me Vendimin e Gjykatës Komunale në Gjilan C. Nr. 256/90, të datës 16 maj 1991, procedurat e iniciuara nga X.H. kanë pushuar. Megjithatë, më 21 janar 2001, Gjykata Komunale në Gjilan me Vendimin C.Nr. 51/2000, i dha R.H. (djalin e X.H.) pronësinë e vetme mbi pronën. Kjo ishte konfirmuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan me Vendimin Ac.Nr. 9/2002, të datës 20 mars 2002. Sidoqoftë, Gjykata Supreme me Vendimin Rev.Nr. 71/2002, të 26 qershorit 2003, anuloi aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale. Rasti u kthye në gjykatën e shkallës së parë.

21. Pas vdekjes së M.S., parashtruesi i kërkesës trashëgoi pronën sipas Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan T. 63/2003. Më 14 maj 2008, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurat gjyqësore C.Nr. 212/08 për pengim të posedimit kundër R.H. Seanca e parë u mbajt më 19 qershor 2008, kur paditësi kërkoi shkarkimin e gjyqtarit M.A. nga rasti. Gjykata e Apelit me vendimin e vet CN.Nr. 5/08, më 27 qershor 2008, hodhi poshtë kërkesën për shkarkim. Më vonë, kërkesa për rihapjen e procedurës, sipas konfirmimit nga Gjykata e Apelit, po ashtu u hodh poshtë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikohen me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 36 të Rregullores së punës.
23. Neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 47(2) i Ligjit, parashohin se individët që ngrenë kërkesë në Gjykatë duhet të dëshmojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.
24. Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi mbi kërkesën për shterim është që t'u ofrohet autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive ligjore për shkeljet e të drejtave kushtetuese (mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999). Kjo gjykatë aplikoi të njëjtin arsyetim kur lëshoi Aktvendimin për papranueshmëri në rastin e Universitetit AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09 i janarit 2010.
25. Siç i është prezantuar Gjykatës, duket se parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren, të lëshuar më 29 janar 2010.
26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, edhe pse Gjykata Kushtetuese i kishte kërkuar të sqarojë kërkesën e tij dhe të dorëzojë *inter alia* një kopje të ankesës ndaj vendimit të datës 29 janar 2010, ai kurrë nuk e bëri këtë. Pavarësisht se, siç u cek më lart, duket se procedurat kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Prizren ende janë në pritje.
27. Gjykata Kushtetuese rikujton se kjo gjykatë nuk duhet të veprojë si Gjykatë e Apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
28. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, të 31 majit 2005).
29. Gjykata rikujton se Gjykata Komunale në Prizren gjeti se padia private penale e parashtruesit të kërkesës është e parregullt dhe e parashkruar. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti që në çfarëdo mënyre procedurat relevante të kenë qenë të padrejta ose arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër. Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).
30. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me kontestin pronësor, Gjykata duhet që së pari të vërtetojë nëse çështjet e ngritura në kërkesë "bien nën

juridiksionin e saj". Lidhur me këtë, Gjykata konsideron se nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës mund vetëm të kërkohet përgjigje për faktet dhe aktet të cilat ndodhën pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të merret me kërkesën lidhur me ngjarjet që ndodhën para se të hyjë në fuqi Kushtetuta (shih, Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në rastin Nr.18/10, Denić *et al*, të datës 17 gusht 2011).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, me shumicë votash

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani